

Nr. 42/1 Prot.

Tiranë, më 04.07.2024

Për: Z. Fatmir Xhafaj
Kryetar
Komisioni i Posaçëm Parlamentar

Lënda: Kthim përgjigje mbi ftesën për bashkëpunim në lidhje me Komisionin e Posaçëm Parlamentar

I nderuar Z. Xhafaj,


Së pari do të doja t'ju falenderoja për vlerësimin ndaj Fondacionit dhe ftesën për bashkëpunim në punën e Komisionit të Posaçëm Parlamentar si dhe proceset e ngritura në lidhje me të dhe të cituara në shkresën me Nr. 2608 Prot. e datës 28.06.2024.

Doja t'ju informoja se Fondacionet e Shoqërisë së Hapur në Ballkanin Perëndimor kanë kaluar një proces transformimi nga i cili ka rezultuar ngritja e një Zyre Rajonale për Ballkanin Perëndimor dhe objekti i aktivitetit të saj është mbështetja e projekteve në nivel rajonal.

Ndërkohë që ne vazhdojmë të ndjekim me shumë interes ecurinë e reformave në fushën e mirëqeverisjes, antikorrupsionit dhe sundimit të ligjit, nuk kemi burimet njerëzore të disponueshme në këto fusha tematike, për shkak të ndryshimit të prioritetëve. Pavarësisht se do të donim të kontribuonim, kapacitetet tona njerëzore në këtë drejtim janë të kufizuara.

Ju urojmë suksese në realizimin e këtij procesi kaq të rëndësishëm për Shqipërinë.

Me konsideratë



Andi DOBRUSHI

Drejtor Ekzekutiv
Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë
Fondacionet Shoqëria e Hapur – Ballkani Perëndimor